

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 68, datë 8.4.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 463, DATË 10.12.2020, “PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE DHE ORGANEVE QË MARRIN TË DHËNA PERSONALE NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE, SI DHE MËNYRËN, LLOJIN DHE SASINË E INFORMACIONIT QË DUHET TË MARRIN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; pikave 2, 2/1 dhe 3, të nenit 3, pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar; si dhe shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 82 dhe nenit 85, të ligjit nr. 124, datë 19.12.2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

1. Në të gjithë përmbajtjen e udhëzimit të përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020, “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, i ndryshuar fjalët “ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, zëvendësohet me “ligji nr. 124, datë 19.12.2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

2. Në aneksin I, pjesë përbërëse e udhëzimit të përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijojnë:

a) Për shkak të një gabimi material, në aneksin e udhëzimit të përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020, dhe përsëritjes së institucionit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), pika 16 përditësohet sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe përmbajtja e pikës 50 fshihet. Lista e subjekteve kontrolluese që do t'i shtohet aneksit I, të vijojë me numrin rendor 50.

b) Pas pikës 49, të aneksit I, shtohen pikat 50, 51, 52 dhe 53.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Ervin Hoxha

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Besnik Dervishi

ANEKSI I

LISTA E INSTITUCIONEVE QË MARRIN INFORMACION, BAZA LIGJORE PËRKATËSE, LLOJI DHE SASIA E INFORMACIONIT QË JEP SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE DHE MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË KËTIJ INFORMACIONI

NR.	SUBJEKTET (KONTROLLUESIT) QË MARRIN TË DHËNA	BAZA LIGJORE	TË DHËNAT PERSONALE QË DUHET TË JEPEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE NË PËRPTHJE ME LEGJISLACIONIN PËRKATËS PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË INFORMACIONIT TË KËRKUAR
16.	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)	Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011, <i>“Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</i> : - Neni 5 <i>“Personat e siguruar”</i> ; - Neni 27 <i>“Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar”</i> .	Të dhënat personale të personave që kanë ndërruar jetë: - Zyra e gjendjes civile në bashki/njësi administrative; - Emër; - Mbiemër; - Numër personal; - Datëlindje; vendlindje; - Emri i babait; - Emri i nënës; - Gjinia; - Gjendja civile; - Shtetësia; - Vendbanimi (adresa); - Data e vdekjes; - Vendi i vdekjes; - Shteti i vdekjes; - Shkaku i vdekjes; - Data e çregjistrimit.	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
50.	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)	Ligji nr. 15/2017, <i>“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”</i> , i ndryshuar. Vendimi nr. 554, datë 31.7.2019 i Këshillit të Ministrave, <i>“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”</i> , i ndryshuar.	Të dhënat e nevojshme për regjistrimin e kursantëve në kurset e formimit profesional si dhe për të dhënat e punonjësve të institucioneve ofruese të formimit profesional, si vijon: - Numri personal; - Emri; - Aftësia; - Mbiemri; - Datëlindja; - Adresa; - Të dhënat për vendbanimin.	Në formë elektronike si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGJC.
51.	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (DPTP)	Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, <i>“Për sistemin e taksave vendore”</i> , i ndryshuar. Germa “e”, e pikës 1, të nenit 4, të vendimit nr. 132, datë	Të dhënat e nevojshme për identifikimin e individëve subjekt i taksës së ndërtesës: - Emër; - Mbiemër;	Në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGJC.

		7.3.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ‘ndërtesa’ e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, i ndryshuar. Vendim nr. 273, datë 16.5.2018, “Për krijimin e regjistrit qendror të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme ‘ndërtese’ (Kadastra Fiskale)”. Vendim nr. 171, datë 28.3.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”.	- Atësia; - Amësia; - Gjinia; - Vendlindje; - Datëlindje; - Adresën.	
52.	Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it	Ligji nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”: - Pika 8, e nenit 3, “Përkufizime”; - Neni 7, “Krijimi, statusi dhe financimi i Agjencisë”; - Neni 6, “Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës”; - Neni 8, “Drejtimi dhe organizimi”. - Germa “ë”, e pikës 2, të nenit 9, “Kompetencat e Agjencisë”. Kreu I, germa “d”, e pikës 2 të nenit 3 dhe kreu IV pika 6, e nenit 9 të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrit të Brendshëm nr. 274, datë 16.5.2024, “Për përcaktimin e procedurave, afateve, kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it, apo të subjekteve të licencuara, apo të lejuara, si dhe të kriterëve etiko-profesionale”.	Të dhënat e nevojshme për vlerësimin dhe verifikimin e pastërtisë së figurës në lidhje me vetëdeklarimin e bërë nga aplikanti/punonjësi dhe të familjarëve, respektivisht si vijon: - informacion lidhur me ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile të nëpunësve të agjencisë; - informacion lidhur me ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile të familjarëve të nëpunësve të agjencisë; - informacion lidhur me ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile të punonjësit të subjektit që do të licencohet.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
53.	Subjektet zgjedhore/partitë politike	Neni 60, i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.	Të dhënat, përbërësit zgjedhorë si më poshtë vijon: - Emri; - Mbiemri; - Atësia; - Datëlindja; - Shtetësi; - Kodi i vendbanimit.	Në formë elektronike.